



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



Manual

SHËRBIMI I NDËRMJETËSIMIT DHE DREJTËSIA RESTAURUESE PËR TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN

Për të miturit në sistemin penitenciar



Save the Children

Manual

SHËRBIMI I NDËRMJETËSIMIT DHE DREJTËSIA RESTAURUESE PËR TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN

Për të miturit në sistemin penitenciar

TIRANË, 2015

Ky manual botohet në kuadër të projektit “Institucionalizimi i Drejtësisë Restauruese dhe Ndërmjetësimit Viktimë-Kundërvajtës për të Miturit në Shqipëri”, që financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga organizata Save the Children në partneritet me Fondacionin “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”.

Përgatitja e manualit u realizua në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

@ Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve të fushës, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e të dy organizatave dhe BE si burim.

Këndvështrimet e autorëve të këtij botimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children dhe FZKPM.

Përmbajtja e këtij botimi dhe pikëpamjet e shprehura në të nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian

Tabela e përmbajtjes

1.	Hyrje	7
2.	Instrumentet ndërkombëtare lidhur me mekanizmin e referimit	7
	a. Niveli i Kombeve të Bashkuara.....	8
	b. Niveli i Këshillit të Evropës	13
3.	Baza ligjore kombëtare	18
4.	Ndërmjetësimi i lidhur me sistemin	22
	e vuajtjes së dënimit	22
5.	Disa këshilla praktike lidhur me hapat e procesit të ndërmjetësimit viktimë- kundërvajtës	25
	Shtojca	32
	1. Model i njoftimit që përdor institucioni referues për referimin e çështjes për ndërmjetësim	32
	2. Model i Marrëveshjes së Ndërmjetësimit	33
	3. Model i Njoftimit që dërgon Shërbimi i Ndërmjetësimit në institucionin referues.....	34

Lista e shkurtimeve

OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
KiE	Këshilli i Evropës
BE	Bashkimi Evropian
K.P	Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë
DUDNJ	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
GjEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KEDNJ	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KDF	Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve

Drejtësia restauruese është një proces në të cilin viktimat, autori, si dhe individë apo përfaqësues nga komuniteti, marrin pjesë aktive për të zgjidhur çështje që dalin si rrjedhojë e kryerjes së një krimi. Rrjedhimisht, programet apo manualët që zhvillohen apo hartohen në funksion të kësaj qasjeje, janë të orientuara nga parimi themelor se sjelljet kriminale jo vetëm konsiderohen si shkelje e ligjit, por gjithashtu sjellin pasoja për viktimat dhe komunitetin.

Në këtë kuptim, botimi i manualit “Shërbimi i ndërmjetësimit dhe drejtësia restauruese për të miturit në konflikt me ligjin” vlerësohet shumë i nevojshëm, pasi vetë drejtësia restauruese është një qasje e re në përgjigje të sjelljeve kriminale si dhe balancimin e nevojave të komunitetit, viktimeve dhe autorëve të këtyre sjelljeve. Ky manual përmbush dhe një kërkesë qytetare, profesionale dhe institucionale për njohjen dhe zbatimin praktik të këtij procesi, i cili ka në fokus të vet arritjen e një marrëveshjeje midis viktimës dhe autorit të kryerjes së krimi.

Praktikat restauruese janë identifikuar si përvoja të suksesshme në nivel evropian dhe më gjerë për trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin dhe ri-integrimin e tyre në jetën normale. Sistemi penitenciar në Shqipëri është hallkë e rëndësishme e zinxhirit të drejtësisë, ku padyshim trajtimi i të miturve ngelet prioriteti kryesor. Bashkëpunimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me organizata të shoqërisë civile në trajtimin dhe zgjidhjen e konflikteve të fokusuar te të miturit në sistemin penitenciar ka qenë me vlera pozitive si për të miturit dhe vetë sistemin.

Projektet e deritanishme të mbështetura nga donatorë ndërkombëtarë si Delegacioni i Bashkimit Evropian, Save the Children dhe UNICEF kanë qenë një mbështetje për të ofruar për të miturit në sistemin penitenciar shërbime sociale dhe juridike që nuk zbatoheshin më parë. Të dhënat e tre viteve të fundit, ku rreth 150 të mitur të sistemit janë përfshirë në procese ndërmjetësimi dhe praktika restauruese, tregojnë se kjo ka qenë një vlerë e shtuar në programet për të miturit që aplikohen në sistemin penitenciar.

Manuali i botuar reflekton një gërshetim të përvojës ndërkombëtare dhe asaj shqiptare në zbatimin e ndërmjetësimit dhe praktikës restauruese për të miturit në konflikt me ligjin. Gjithashtu, manuali përmban një sërë rregullimesh ligjore dhe standardesh që duhet të njihen dhe përvetësohen nga punonjësit e sistemit penitenciar të cilët punojnë me të miturit në konflikt me ligjin. Për më tepër, manuali prezanton qartë idenë se sistemi penitenciar duhet të ofrojë një mjedis ku të miturit, në bashkëpunim me punonjësit, prindërit dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile duhet të përfshihen aktivisht në aktivitete rehabilituese, ri-integruese dhe pajtuese.

Në përfundim, duke shprehur vlerësime për punën e bërë në hartimin e këtij manuali, jam i bindur se përdorimi i tij nga stafi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve të çdo niveli, do të rrisë ndjeshëm kuptimin, si dhe aplikimin e drejtësisë restauruese në veçanti për të miturit.


Artur ZOTO

Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

1 NDËRMJETËSIMI DHE DREJTËSIA RESTAURUESE PËR TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN

Rasti i të miturve në sistemin penitenciar

1. Hyrje

Mbipopullimi i burgjeve dhe rritja e popullsisë përbëjnë një sfidë të një rëndësie të madhe në lidhje me administrimin e burgjeve dhe të sistemit të drejtësisë penale, si në konceptin e të drejtave të njeriut, edhe në atë të menaxhimit efikas të institucioneve penale. Situata e përgjithshme mbi krimin dëshmon për rritje të numrit të personave të dënuar ndaj edhe është domosdoshmëri rritja e shkallës së masave me natyrë edukuese dhe riedukuese, me qëllim riintegrimin e kontingjentit të personave të përfshirë në vepra penale.

Masat e marra duhet të përcaktohen në kuadrin e një politike koherente dhe racionale ndaj krimit të drejtuar për parandalimin e veprave penale, forcimit të ligjit, sigurisë publike dhe mbrojtjes, individualizimit të sanksioneve dhe masave e riintegrimin social të shkelësve të ligjit. Në këto kushte merr një rol më të madh alternativa e zgjidhjes së konflikteve me ndërmjetësim si në kontingjentin e personave të dënuar, ashtu edhe në marrëdhëniet e tyre me njëri-tjetrin apo me familjarët e viktimave që ata kanë shkaktuar.

2 Instrumentet ndërkombëtare lidhur me mekanizmin e referimit

Dispozitat lidhur me devijimin janë të shpërndara në disa instrumente ndërkombëtare ku vendin kryesor e zënë ato që lidhen me çështjet e drejtësisë për të miturit.

Analiza e instrumenteve ndërkombëtare bëhet duke i renditur këto norma nisur nga organizata ndërkombëtare, e cila e ka prodhuar

dokumentin normativ. Kështu, trajtimi i standardeve ndërkombëtare do të bëhet në dy nivele të ndryshme: në atë të Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe të Këshillit të Evropës (KiE). Standardet ndërkombëtare përcaktojnë detyrime, të cilat konsistojnë në *standardet minimum*. Kjo nënkupton se çdo shtet nuk mund të ulë këtë nivel në kuadrin e vet ligjor dhe në zbatimin e së drejtës, por nga ana tjetër është plotësisht i inkurajuar për një standard më të lartë sesa përcaktohet në konventë apo dokument.

Për punonjësit e administratës së burgjeve, njohja me instrumentet ndërkombëtare vlen me qëllim zbatimin e tyre.

a. Niveli i Kombeve të Bashkuara

Më poshtë janë renditur dokumentet më të rëndësishme:

- Konventa e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës (1989), ratifikuar nga Shqipëria më 27 shkurt 1992;
- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (1948);
- Rregullat Standard Minimum të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (Rregullat e Pekinit 1985);
- Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të rinjve, të cilëve u është hequr liria (rregullat e Havanës 1990);
- Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për parandalimin e kriminalitetit të të rinjve (udhëzimet e Riadit 1990);
- Rregullat Standard Minimum të Kombeve të Bashkuara lidhur me Masat e Mosarrestimit (rregullat e Tokios) (1990);
- Udhëzime për veprim ndaj fëmijëve në sistemin e drejtësisë penale – Aneks i Rezolutës 1997/30 të OKB mbi Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (Udhëzimet e Vienës) në të cilën udhëzohen shtetet për ndërmjetësim.

Konventa për të Drejtat e Fëmijës

KDF është një instrument sintetik ku në mënyrë gjithëpërfshirëse gjenden parimet kryesore për mbrojtjen e të drejtave të të miturve në tërësi dhe standardet bazë për zbatimin e drejtësisë penale për të miturit. Mesazhi që vjen prej kësaj konvente është se duke qenë ndryshe, pikërisht

sepse është një qenie në zhvillim e sipër, fëmija, ka ende kohë e mundësi për t'u rehabilituar, ka nevoja të ndryshme prej të rriturve dhe terapitë që sistemi do të përdorë për "shërimin" e tyre janë dhe duhet të jenë krejt të ndryshme e të veçanta prej atyre të të rriturve. Me çdo fëmijë duhet të merresh në mënyrë të individualizuar. Mbrojtja e veçantë e të miturve përbën një interes të fortë publik, interesi parësor dhe mirëqenia e të miturve janë themelore.

Çështjet që lidhen me drejtësinë penale për të miturit janë kryesisht ato të përfshira në nenin 37, 39 dhe 40 të KDF.

Neni 37 i KDF ka në përmbajtjen e vet ndalimin e torturës dhe trajtimit mizor, degradues, çnjerëzor. Nuk duhet të ketë *as dënim me vdekje dhe as burgim të përjeshëm për fëmijët; arrestimi, ndalimi ose burgimi* i një fëmije duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe *të përdoret vetëm si një masë e fundit dhe për një kohë sa më të shkurtër*; çdo fëmijë i privuar nga liria duhet të trajtohet në mënyrë njerëzore, duhet të jetë i veçuar nga të rriturit dhe duhet të jetë gjithnjë në kontakt me familjen e tij; fëmijët e privuar nga liria kanë të drejtë për *asistencë juridike* dhe të drejtë për të kundërshtuar privimin e lirisë dhe të merret një *vendim i shpejtë* në lidhje me çështjen etj.

Udhëzimet e OKB-së

- *Rregullat Standard Minimum të Kombeve të Bashkuara lidhur me masat e mosarrestimit (rregullat e Tokios) (1990)*

Përmes këtyre rregullave vendosen një paketë parimesh që kanë për qëllim promovimin e masave të sigurisë që nuk kanë të bëjnë me arrestin në burg, si dhe disa standarde minimum lidhur me personat, të cilët janë në kushtet e vuajtjes së alternativave të dënimit me burgim. Këto rregulla promovojnë sanksionet në komunitet dhe ndalen kryesisht në:

- Sistemi i drejtësisë duhet të përmbajë në masë të konsiderueshme sanksionet në komunitet si në fazën para procedimit gjyqësor, ashtu edhe pas dhënies së dënimit;
- Shmangia sa më shumë nga dënimi me burgim në rastet e panevojshme;
- Shkelësit e ligjit duhet të kenë të bëjnë (të japin llogari) me komunitetin;
- Inkurajimin në rritje të sanksioneve në komunitet dhe

shmangien nga proceset formale kur kjo është e mundur (drejtësia restauruese);

- Inkurajimi i përfshirjes së komunitetit në zbatimin e sanksioneve në komunitet.

□ Udhëzimet e Riadit¹

Këto udhëzime i dedikohen parandalimit të kriminalitetit të të miturit të bazuar mbi këto parime themelore:

- Të rinjtë mund të zhvillojnë qëndrime jokriminale nëpërmjet përfshirjes në aktivitete të ligjshme e të dobishme për shoqërinë dhe nëpërmjet mbajtjes së një qëndrimi humanist ndaj shoqërisë dhe këndvështrimit mbi jetën.
- Parandalimi i suksesshëm i kriminalitetit të të miturve kërkon përpjekje nga e gjithë shoqëria, për të siguruar një zhvillim harmonik të adoleshentëve, duke respektuar dhe mbrojtur personalitetin e tyre që në fëmijërinë e hershme.
- Për interpretimin e këtyre udhëzimeve, duhet ndjekur një orientim që në qendër të vendoset fëmija. Të rinjtë duhet të kenë një rol aktiv dhe partneriteti brenda shoqërisë dhe nuk duhet trajtuar thjesht si objekt shoqërizimi ose kontrolli.
- Në zbatimin e këtyre udhëzimeve, në përputhje me sistemin ligjor kombëtar, mirëqenia e të rinjve, duke filluar që nga fëmijëria e hershme, duhet të jetë fokusi i të gjitha programeve parandaluese.
- Duhet të njihet dhe të vlerësohet nevoja dhe rëndësia e politikave të parandalimit progresiv të kriminalitetit dhe të studimit sistematik e përpunimit të masave të nevojshme. Këto duhet të shmangin inkriminimin dhe penalizmin e fëmijës për sjellje që nuk i shkaktojnë dëme të rëndësishme zhvillimit të tij ose nuk dëmtojnë të tjerët.
- Duhet të zhvillohen shërbime dhe programe të bazuara në komunitet për parandalimin e kriminalitetit të të miturve, në mënyrë të veçantë aty ku ende nuk ka agjenci. Agjencitë formale të kontrollit social zakonisht duhen përdorur vetëm si mjet i fundit.

1 Adaptuar dhe shpallur nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën 45/112 në 14 dhjetor 1990.

□ **Rregullat Standard Minimum të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (Rregullat e Pekinit)²**

Standardeve minimum synojnë krijimin e një sistemi të specializuar të drejtësisë për të miturit dhe krijimin e një legjislacioni të posaçëm. Këtu veçojmë:

- përjashtimin e të miturit prej dënimit kapital dhe prej ndëshkimeve trupore;
- trajtimin e paanshëm dhe njerëzor;
- mbajtjen parasysh të mendimeve të të miturit;
- burgimi të jetë mundësia e fundit dhe qëndrimi në burg të jetë sa më i shkurtër që të jetë e mundur;
- heqja e lirisë duhet të aplikohet për raste shumë të rënda;
- riintegrimi i të miturit.

Komentari zyrtar i këtij dokumenti, shpjegon qartë të mirat dhe përfitimet e devijimit dhe jep sqarime të rregullit 11. Rregulli 11 i këtij dokumenti i referohet devijimit p.sh 11.1 promovon devijimin në parim, 11.2 liston një gamë të gjerë aktorësh që duhet të përdorin devijimin, 11.3 nënvizon nevojën e pranimit/miratimit dhe 11.4 promovon programet me bazë komunitare.

□ **Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të rinjve të cilëve u është hequr liria (Rregullat e Havanës)³**

Në tekstin e këtij dokumenti nënvizohen disa nga parimet për mbrojtjen e të rinjve të cilëve u është hequr liria të tilla si:

- heqja e lirisë është masa e fundit dhe kjo duhet të ketë kohëzgjatje të kufizuar;
- heqja e lirisë për të miturit nuk mund të bëhet pa një motiv juridik objektiv;
- krijimi i njësive të institucioneve të hapura të jetë prioritet
- përgatitja e të miturve të cilëve u është hequr liria për rikthimin e lirisë dhe rikthimin në komunitet dhe rëndësia e programeve edukuese për ta;
- mbajtja e kontakteve me familjen;

2 Miratuar nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 40/33 më 29 nëntor 1985.

3 Aprovuar nga Rezoluta e Asambleja se Përgjithshme 45 / 113 e 14 dhjetorit 1990.

- trajnimi i personelit të institucioneve ose të qendrave.
- **Udhëzues për veprim ndaj fëmijëve në sistemin e drejtësisë penale⁴**

Në pikën 15 të këtij dokumenti nënvizohet se:

“15. Duhet ndërmarrë një rishikim i procedurave ekzistuese dhe aty ku është e mundur. Devijimi ose iniciativat alternative kundrejt sistemit klasik të drejtësisë penale duhet të zhvillohen me qëllim që të shmangët çuarja drejt sistemit penal të drejtësisë e të rinjve që akuzohen për një shkelje. Hapat e duhur duhet të ndërmerren me qëllim që në të gjithë vendin të mund të zbatohen masat alternative dhe masat edukuese përpara arrestimit, përpara gjykimit, gjatë dhe pas gjykimit, me qëllim për të parandaluar recidivizmin dhe promovohet rehabilitimi social i fëmijëve dhunues. Aty ku është e përshtatshme, mekanizmat e zgjidhjeve informale të mosmarrëveshjeve në rastet e fëmijëve shkelës të ligjit duhet të përdoren, duke përfshirë këtu ndërmjetësimin dhe praktikën e drejtësisë restauruese, veçanërisht proceset që përfshijnë pjesëmarrjen e viktimës. Në masat e ndërmarra për këtë qëllim duhet të përfshihet edhe familja, në masën që kjo e fundit vepron në favor të së mirës për fëmijën shkelës të ligjit. Shtetet duhet të sigurojnë që këto masa janë në përputhje me KDF, rregullat standarde të OKB mbi drejtësinë për të miturit, si dhe me norma të tjera që ekzistojnë për parandalimin e kriminalitetit dhe të drejtësisë penale siç janë ato të sipërcituara. Në këto raste vëmendje duhet t’i kushtohet procesit të rregullt në rast se zbatohen këta rregulla si edhe parimet të ndërhyrjes minimum”.

Në një dokument ‘soft law’ të OKB me titull ‘Qasja e Kombeve të Bashkuara ndaj drejtësisë për të miturit’ të vitit 2008⁵, në parimin 8, (heqja e lirisë së fëmijës duhet të jetë mjeti i fundit dhe për një kohë shumë të shkurtër të mundshme) thuhet se: *“duhet të ketë rregullime lidhur me drejtësinë restauruese, mekanizmat e devijimit dhe dënimet alternative të heqjes së lirisë. Për të njëjtën arsye, programet e drejtësisë për të miturit mund të ndërtohen mbi sistemin informal të drejtësisë tradicionale sa kohë që standardet dhe parimet bazike të të drejtave të njeriut të tilla si barazia gjinore respektohen”.*

4 Guidelines for Action on Children in the Criminal Justice System (Annex to UN Resolution 1997/30 – Administration of Juvenile Justice (‘Vienna Guidelines’), 1997.

5 Shih: UN Common Approach to Justice for Children, në:
https://www.essex.ac.uk/armedcon/story_id/UNCOMMON.pdf

b. Niveli i Këshillit të Evropës

Në këtë kontekst, ndër dokumentet më me rëndësi, veçojmë:

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut KEDNJ⁶ dhe Protokollet nr. 1; 2; 4; 6; 5; 11;7; Karta Sociale Evropiane (e rishikuar)⁷; Konventa Evropiane “Për parandalimin e torturës dhe dënimeve dhe trajtimeve çnjerëzore ose degraduese”⁸ dhe Protokollit nr.1 dhe 2; “Konventa Evropiane për mbikëqyrjen e personave të dënuar ose të liruar me kusht” (ligji nr.8724/26.12.2000); “Konventa e Këshillit të Evropës “Për transferimin e personave të dënuar”, (Ligji nr.8499/10.6.1999); Konventa e Këshillit të Evropës “Për ndihmën e ndërsjellë juridike në çështjet penale” (ligji nr.8498/10.6.1999); Konventa e Këshillit të Evropës “Për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjyqimeve penale” (Ligji nr.9068/15.5.2003); Konventa e Këshillit të Evropës “Për transferimin e procedimeve penale” (Ligji nr. 8497/10.6.1999)

Rekomandime dhe rezoluta të Këshillit të Evropës

- Këtu rendisim:
- Rekomandimi nr. (92)16 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi rregullat europiane për sanksionet dhe masat në interes të komunitetit;
- Rekomandimi nr. (2000)22 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi përmirësimin e implementimit të rregullave europiane për sanksione dhe masat në komunitet;
- Rekomandimi nr. (2003)22 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për lirinë me kusht (parole);
- Rekomandimi nr. (97)12 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për stafin i cili merret me zbatimin e dënimeve dhe

6 Konventa garanton të drejtën për jetën (neni 2), të drejtën për lirinë dhe sigurinë e personit (neni 5) dhe të drejtën për të qenë i lirë nga tortura, trajtimi çnjerëzor ose degradues (neni 3). KEDNJ ka efekt të drejtpërdrejtë në ligjet e brendshme, dhe gjyqësori duhet të mbështetet në dispozitat e Konventës Evropiane dhe jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut. Konventa është nënshkruar më 13.7.1995, ratifikuar dhe hyrë në fuqi më 2.10.1996 (ligji nr.8137, datë. 31.07.1996)

7 Karta Sociale Evropiane (e rishikuar) nënshkruar më 21.9.1998, hyrë në fuqi më 1.01.2003;

8 Nënshkruar me 02.10.1996, ratifikuar më 02.10.1996 dhe hyrë në fuqi 1.01.1997. Ligji nr.8135/31.7.1996.

masave

- Rekomandimi nr. (99)22 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare në lidhje me mbipopullimin e burgjeve dhe inflacionin e popullimit të burgjeve;
- Rekomandimi nr. (99)19 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për shtetet anëtare në lidhje me ndërmjetësimin në çështjet penale.

i. Konventa Evropiane për Mbikëqyrjen e Personave të Dënuar ose të Liruar me Kusht (Ligji Nr.8724/ 26.12.2000)

Konventa evidenton rëndësinë që ka rehabilitimi social i autorëve të veprave penale të dënuar apo të liruar me kusht, si edhe nga ana tjetër vënia në ekzekutim e sanksioneve të vendosura nga gjykata në rastin kur kushtet e parashikuara prej saj nuk janë përmbushur.

ii. Konventa e Këshillit të Evropës “Për transferimin e personave të dënuar” (Ligji Nr. 8499/10.6.1999)

Qëllimi i konventës është arritja e unitetit dhe zhvillimi i një bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e së drejtës penale; çuarja më tej e qëllimeve të drejtësisë dhe rehabilitimi shoqëror i personave të dënuar; mundësia që të huajve të dënuar me heqje lirie, duke i transferuar në vendet e tyre t’u jepet mundësia të vuajnë dënimin në shoqërinë e tyre.

iii. Rekomandimet “Soft Law”⁹

- Rekomandimi nr. (92)16 i Komitetit të Ministrave për

⁹ Rezolutës (65) 1 mbi pezullimin e dënimit, lirimit me provë dhe mënyrave të tjera alternative ndaj burgimit; Rezolutës (70) 1 mbi organizimin praktik të masave për mbikëqyrjen dhe kujdesin e mëpasshëm të dënuarve apo të liruarve me kusht; Rezolutës (76) 2 mbi trajtimin e të dënuarve me afate të gjata burgimi; Rezolutës (76) 10 mbi disa masa penale alternative ndaj burgimit; Rekomandimit Nr. R (82) 16 mbi dhënien e lejes të burgosurve; Rekomandimit Nr. R (87) 3 mbi Rregullat Evropiane të Burgut; Rekomandimit Nr. R (89) 12 mbi edukimin në burgje; Rekomandimit Nr. R (92) 16 për rregullat evropiane mbi sanksionet dhe masat e komunitetit; Rekomandimit Nr. R (92) 11 në lidhje me njëtrajtshmërinë (konsistencën) në dënime; Rekomandimit Nr. R (97) 12 për stafin e ngarkuar me zbatimin e masave dhe dënimeve; Rekomandimit Nr. R (99) 22 për mbipopullimin e burgjeve dhe inflacionin e popullatës së burgjeve;

Shtetet Anëtare mbi rregullat europiane për sanksionet dhe masat (në interes) të komunitetit

Ka 90 rregulla dhe një fjalorth me 14 përkufizime lidhur me termat e përdorur.

Një rëndësi të veçantë në këtë dokument merr fjalorthi i termave. Për efekt të këtij manuali të veçojmë disa prej tyre.

“**Sanksione e masa në interes të komunitetit**” janë sanksionet dhe masat e dhëna nga gjykata përmes një vendimi gjyqësor, të cilat e mbajnë shkelësin e ligjit në komunitet, por me disa kufizime të lirisë së tij nëpërmjet imponimit të kushteve dhe/ose detyrimeve, të cilat zbatohen nga organet e përcaktuara në ligj për këtë qëllim.

“**Masa të komunitetit**” janë veprime të ndërmarra përpara ose në vend të një vendimi mbi një sanksion, si dhe mënyrat e hyrjes në fuqi të një vendimi për burgim jashtë institucionit të burgut. Kështu, për shembull, lirimi me kusht është një masë përderisa është një mënyrë zbatimi e dënimit me burg në komunitet.

“**Mbikëqyrja**” u referohet si *aktiviteteve ndihmëse* të kryera në emër të një autoriteti zbatues që kanë si qëllim të mbajnë shkelësin e ligjit në shoqëri, ashtu edhe *veprimeve* që ndërmerren për të siguruar që shkelësi i ligjit të përmbushë çdo kusht ose detyrim të imponuar. Shërbimi i mbikëqyrjes (shërbimi i provës sipas legjisllacionit shqiptar) është agjencia që sipas ligjit realizon mbikëqyrjen.

Termi “**kontroll**” u referohet veprimtarive që kufizohen me verifikimin, nëse plotësohen kushtet ose detyrimet e vëna, si dhe veprimtarive, për të siguruar respektimin e tyre duke përdorur, ose kërcënuar se do të përdoren, procedurat e disponueshme në rast mosrespektimi. Nocioni i kontrollit është më i ngushtë se ai i mbikëqyrjes.

Me “**pjesëmarrje të komunitetit**” do të kuptojmë të gjitha format e ndihmës, me ose pa pagesë, të kryer me orë të plota ose të pjesshme ose në mënyrë sporadike, që vihen në dispozicion të autoritetit zbatues (shërbimit të provës) ose organizatave publike ose private dhe individëve të komunitetit.

□ Rekomandim nr. (2003)22 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për lirim me kusht (parole)

Rekomandimi nënvizon se lirim me kusht është një nga mënyrat më efektive dhe konstruktive për të parandaluar përsëritjen e krimeve dhe për të promovuar rivendosjen, duke i bërë të burgosurit një integrim të planifikuar, të asistuar dhe të mbikëqyrur në shoqëri. Por efikasiteti varet shumë nga përshtatja me kushtet individuale të të dënuarit dhe në përputhje me parimet e një procesi të rregullt dhe të drejtë ligjor. Në këtë mënyrë, në shtojcën apo aneksin e këtij rekomandimi ne gjejmë parimet nga të cilat duhet të udhëhiqet legjislacioni, politikat dhe praktikat në lidhje me lirim para kohe me kusht.

Si qëndron çështja e lirit me kusht për recidivistët? A ka një mundësi për ta?

Parimi 4/a i Rekomandimit (2003) 22 mbi lirim me kusht e parashikon këtë mundësi edhe për recidivistët.

□ Rekomandim nr. (97)12 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare për stafin, i cili merret me zbatimin e dënimeve dhe masave

Rekomandimi mbi rregullat europiane për sanksionet dhe masat (në interes) të komunitetit parashikon (*Rregulli 29*) se aty ku bëhen marrëveshje për dhënien e ndihmës për autoritetin zbatues në formën e aktiviteteve të duhura mbikëqyrëse të kryera kundrejt pagesës nga organizata a individë të marrë nga komuniteti, përgjegjësia për të siguruar që shërbimet e siguruar janë në përputhje me kërkesat e rregullave aktuale i mbetet autoritetit zbatues. Autoriteti zbatues duhet të vendosë mbi veprimin që duhet të ndërmerret nëse ndihma e dhënë nuk përputhet me kërkesat. Autoriteti zbatues duhet të vendosë gjithashtu mbi veprimet që duhen ndërmarrë nëse aktivitetet mbikëqyrëse zbulojnë që shkelësi i ligjit nuk i është përmbajtur një kushti ose detyrimi a udhëzimi që rrjedh nga sanksioni ose masa e komunitetit e imponuar. Rregulli 47 parashikon se pjesëmarrja e komunitetit duhet të sigurohet me anë të një marrëveshjeje me autoritetin zbatues përgjegjës që specifikon në veçanti natyrën e detyrave dhe mënyrën sesi do të kryhen ato.

Padyshim që zbatimi me sukses i dënimeve dhe masave në interes të komunitetit mund të arrihet vetëm përmes një koordinimi

ndërinstitucional, bashkëpunimit ndërmjet niveleve të ndryshme hierarkike dhe një stafi shumë profesional dhe bashkëpunues, të kualifikuar dhe të përkushtuar. Rekomandimi u kushton kujdes të veçantë cilësive morale e profesionale që duhet të gëzojë stafi që do të angazhohet në këtë veprimtari. Rekomandimit i janë bashkangjitur dy anekse të rëndësishme. Në Aneksin I gjenden parimet për rekrutimin, përzgjedhjen, trajnimin, kushtet e punës dhe lëvizjen e stafit që merret me zbatimin e sanksioneve dhe masave, ndërsa në Aneksin II jepen udhëzime etike për këtë staf duke përfshirë kërkesa të përgjithshme etike, kërkesa etike në lidhje me të dyshuarit ose të dënuarit.

□ Rekomandimi nr. (99) 22 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare në lidhje me mbipopullimin e burgjeve dhe inflacionin e popullimit të burgjeve

Komiteti i Ministrave rekomandon që qeveritë e shteteve anëtare të marrin të gjitha masat e duhura gjatë rishqyrtimit të legjisllacionit dhe praktikave në lidhje me mbipopullimin e burgjeve dhe inflacionin e popullimit të burgjeve, me qëllim aplikimin e parimeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të nxisin shpërndarjen sa më gjerë të jetë e mundur të Rekomandimit dhe raportit mbi mbipopullimin e burgjeve e atë të inflacionit të popullimit të burgjeve të hartuar nga Komiteti Evropian mbi Problemet e Krimin.

Çështja e mbipopullimit të burgjeve vë gjithnjë në dilemë disa standarde të rëndësishme lidhur me respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe sistemin e drejtësisë penale. Rekomandimi lidhet ngushtësisht me rekomandimet e tjera të renditura në këtë Udhëzues (dhe të tjera) dhe ka për qëllim të nxisë marrjen e masave të duhura gjatë rishqyrtimit të legjisllacionit dhe praktikave në lidhje me mbipopullimin e burgjeve dhe inflacionin e popullimit të burgjeve çka nënkupton një kujdes edhe më të madh ndaj sanksioneve dhe masave në komunitet.

□ Rekomandimi nr. (99) 19 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për shtetet anëtare në lidhje me ndërmjetësimin në çështjet penale

Sipas pikës 4 të Rekomandimit nr. (99) 19, ndërmjetësimi në çështjet penale duhet të jetë i disponueshëm në të gjitha fazat e procesit të

drejtësisë penale. Praktika ka treguar se ka më shumë gjasa që ndërmjetësimi të jetë i suksesshëm në fazat e hershme. Zgjidhja e konfliktit përmes ndërmjetësimit ul kostot publike financiare dhe rivendos një marrëdhënie më të mirë ndërmjet viktimës, kundërvajtësit dhe shoqërisë.

3. Baza ligjore kombëtare

a. Kodi i Procedurës Penale

Metoda alternative e zgjidhjes së konflikteve penale rregullohet nga legjislacioni shqiptar procedural penal. Në zgjidhjen me ndërmjetësim të konflikteve penale, një rol të rëndësishëm ka sistemi gjyqësor shqiptar. Në traditën e këtij legjislacioni është pranuar e drejta e gjykatës, si dhe detyrimi i saj, për të kryer veprime dhe për të bërë përpjekje në zgjidhjen me ndërmjetësim e pajtim të rasteve penale të parashikuara në ligj.

Kjo gjë ndodh në dy raste kryesore:

Duke iu referuar *nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale*, për një kategori rastesh penale, të tilla si: rrahja, plagosja e rëndë nga pakujdesia, plagosje e lehtë nga pakujdesia, dhunimi i banesës, shpifja dhe disa raste të tjera, i dëmtuari, (viktima) ka të drejtë të paraqesë kërkesë drejtpërdrejt në gjykatë për fillim të çështjes penale dhe të marrë pjesë në gjykim si palë, për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit.

Bazuar në Kodin e Procedurës Penale për rastet e mësipërme, gjykata fton së bashku viktimën dhe të akuzuarin dhe u propozon të zgjidhin çështjen me ndërmjetësim. Nëse i dëmtuari, viktima bindet të tërheqë kërkesën për procedim penal dhe ai që akuzohet e pranon këtë tërheqje, gjykata vendos pushimin e çështjes dhe palët në konflikt i drejtohen ndërmjetësimit

Gjithashtu, sipas *nenit 284 të Kodit të Procedurës Penale* janë përcaktuar edhe rastet e konflikteve penale që procedimi penal fillon nga prokuroria ose policia gjyqësore vetëm duke u bazuar në ankimin e viktimës, të dëmtuarit ndaj të akuzuarit, i cili mund të tërheqë ankimin duke iu drejtuar ndërmjetësimit në çdo fazë të procedimit. Këto raste janë plagosje e lehtë pa dashje, vrasje nga pakujdesia, fyerje e shpifje për shkaqe të detyrës etj.

b. Kodi Penal

Kodi Penal, me nenet 90-92, 112/1, 119-122, 125, 127, 148, 149, 254, të cilat parashikojnë vepra penale me rrezikshmëri më të ulët ose kundërvajtje penale, lë hapësirën e pajtimit për vepra të tilla si rrahja, plagosja e rëndë dhe e lehtë nga pakujdesia, dhunimi i banesës, fyerja, shpifja, si dhe me nenet 85, 89, 102/1, 105, 106, 130, 239-241, 243, 264, 275 dhe 318, kur procedimi penal fillon nga prokuroria ose policia gjyqësore vetëm duke u bazuar në ankimin e viktimës, të dëmtuarit ndaj të akuzuarit si shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, plagosja e lehtë me dashje etj.

Nga praktika gjyqësore dhe konkretisht gjatë hetimit të çështjeve penale nga organi i akuzës ka rezultuar se këto vepra penale, ku ligji nuk parashikon heqjen dorë nga i dëmtuari nga ndjekja penale për të akuzuarin, kanë një përqindje mjaft të lartë të zgjidhjes së tyre me përfundimin e pushimit të çështjeve duke qenë të ndikuara pikërisht nga një ndërmjetësim dhe pajtim i arritur nga palët, si dhe marrëveshjes mes tyre. Vepra të tilla penale janë: kanosja, (neni 84 i K.Penal), vrasja nga pakujdesia, (neni 85 i K.Penal), shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, (neni 290 i K.Penal). Këto vepra në një pjesë të konsiderueshme kanë gjetur mirëkuptim dhe marrëveshje mes palëve nëpërmjet ndërmjetësit, të cilat kanë sjellë si rezultat heqjen dorë të të dëmtuarit akuzues, pushimin e çështjeve ose shpalljen fajtor të të akuzuarit duke marrë dënimin më minimal të mundshëm.

c. VKM Nr. 303, datë 25.3.2009 ndryshuar me V.K.M-në nr.187, datë 17.03.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 303, datë 25.03.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”

Nenet 50 dhe 51 parashikojnë masat me natyrë parandaluese dhe ato disiplinore sipas të cilave në raste urgjente, në mënyrë që të parandalohet dëmi ndaj njerëzve, prishja e rregullit, përhapja e trazirave, si dhe në rrethana të jashtëzakonshme, mund të merren masa, duke përjashtuar një të burgosur nga aktivitetet në grup dhe duke e vendosur në një dhomë të veçantë në pritje të mbledhjes së komisionit disiplinor, i cili vendos për masën disiplinore. Masat disiplinore jepen nga më e lehta deri te më e rënda, sipas klasifikimit të shkeljeve. Të tilla mund të jenë: përjashtimi nga

të gjitha veprimtaritë e përbashkëta deri në 20 ditë, në ambiente të veçanta, ndërprerja e lejeve për një periudhë gjashtëmujore, përjashtim nga ajrosja në grup, por jo më shumë se 20 ditë etj. Në rast të konflikteve të shkaktuara midis të burgosurve në ambientet e burgut, administrata e burgjeve mund të ndërhyjë për ta zgjidhur konfliktin me marrëveshje.

d. Ligji nr. 10385, datë 24.02.2011, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”

Ligji “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, 10385/2011 përbën bazën kryesore ligjore për funksionimin dhe realizimin e shërbimit të ndërmjetësimit. Ai përshkruan dispozitat bazë që duhet të ndiqen nga ndërmjetësi, si dhe bazën për procesin e plotë të ndërmjetësimit, duke filluar me referimin e çështjes, e më pas me procedurën e ndërmjetësimit, caktimin e ndërmjetësit dhe raportimin në gjykatë/institucion tjetër referues lidhur me rezultatin e çështjes së ndërmjetësuar.

Fusha e zbatimit të ligjit përcaktohet në nenin 2 të ligjit për ndërmjetësimin, si vijon:

- Ndërmjetësimi, zbatohet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile, penale e tregtare në çdo kohë që palët në konflikt, me vullnetin e tyre të lirë, kërkojnë dhe pranojnë ndërmjetësimin si alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, pavarësisht nëse mosmarrëveshja është paraqitur përpara organit të përcaktuar nga ligji për zgjidhjen e saj. Dispozitat e ndërmjetësimit zbatohen edhe në ato raste kur gjykata ose organi përkatës shtetëror, pas vënies në lëvizje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, orientojnë palët drejt ndërmjetësimit.
- Ndërmjetësimi zbatohet për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve në fushën e së drejtës civile, tregtare, të punës dhe familjare;
- *Ndërmjetësimi në fushën penale zbatohet për mosmarrëveshjet që shqyrtohen nga gjykata me kërkesën e të dëmtuarit akuzues, ose me ankim të të dëmtuarit, sipas neneve 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në çdo rast kur ligji i veçantë e lejon atë. Në rastin e mosmarrëveshjeve në fushën penale, kur procedimi penal ka*

nisur, gjykata detyrimisht fton palët për zgjidhjen me ndërmjetësim të mosmarrëveshjeve të parashikuara në ligj.

- Kur vihet në lëvizje për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje në fushën e së drejtës civile, tregtare, të punës ose familjare, gjykata ose organi përkatës shtetëror, brenda kompetencave të parashikuara në ligj, detyrimisht ftojnë palët për zgjidhjen me ndërmjetësim, veçanërisht, por pa e kufizuar vetëm në to, të mosmarrëveshjeve lidhur me:
 - çështjet civile dhe familjare, kur ndërthuren interesat e të miturve;
 - çështjet e pajtimit në rastet e zgjidhjes së martesës, të parashikuara nga neni 134 i Kodit të Familjes;
 - çështjet me karakter pasuror me objekt padie deri në 500 mijë lekë, si dhe për paditë për kërkimin e sendit, për paditë mohuese e për paditë për pushimin e cenimit të posedimit;

A ka raste të tjera, në fushën penale, që mund të ndërmjetësohen?

Vetë ligji i ndërmjetësimit parashikon mundësinë e ndërmjetësimit kur ligji i veçantë e lejon atë duke e lënë kështu këtë mundësi në varësi të rregullimeve të tjera ligjore, p.sh urdhri nr. 6325, datë 31.7.2009 “Për miratimin e Rregullores “Për bashkëpunimin e Shërbimit të Provës me OJF-të dhe Shërbimin e Ndërmjetësimit”, të ministrit të Drejtësisë, si edhe VKM nr.302, datë 25.3.2009 për miratimin e rregullores “Për organizimin e funksionimin e Shërbimit të Provës dhe për përcaktimin e standardeve e të procedurave, për mbikëqyrjen e ekzekutimit të dënimeve alternative”.

Pra ligji na tërheq vëmendjen në tre raste të mundshme për t’u ndërmjetësuar dhe të detyrueshme që organi procedues të bëjë “ftesën për ndërmjetësim”:

- Çështjet me kërkesën e të dëmtuarit akuzues,
- Çështjet me ankimin e të dëmtuarit,
- Çështjet kur ligji i veçantë e lejon ndërmjetësimin.

4. Ndërmjetësimi i lidhur me sistemin e vuajtjes së dënimit

A është ndërmjetësimi i mundshëm në të gjitha shkallët e procedimit penal?

Kësaj pyetjeje edhe legjislacioni shqiptar, (ashtu si ai ndërkombëtar) i ka dhënë përgjigje pozitive. Procesi i ndërmjetësimit është i mundshëm jo vetëm brenda hallkave të procesit gjyqësor, por edhe pas vendimit të gjykatës për ta shpallur personin fajtor për një veprë penale. Gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit, personi i dënuar mund të shfaqë një shkallë pendimi ose dëshire për t'u pajtuar me viktimën ose familjarët e tij/saj.

Edhe sipas pikës 4 të Rec. (99), nr. 19 të Kom. të Min të KE-së ndërmjetësimi është i mundshëm në të gjitha fazat e gjykimit të çështjes penale. Pa diskutim që praktika dëshmon se fazat më të hershme kanë më shumë mundësi për ndërmjetësim të suksesshëm. Megjithatë, ka pasur raste kur kjo procedurë ka vepruar me sukses edhe gjatë kohës që personi është duke vuajtur dënimin me heqje lirie ose me kusht pranë shërbimit të provës.

Administrata e Burgjeve ka një rol mjaft të rëndësishëm së bashku me gjykatën për të krijuar mundësitë e parandalimit të veprave penale të reja ose për parandalimin e shndërrimit të të dënuarit në një kontingjent përsëritës të veprave penale. Ky shërbim kryen kontroll mbi të dënuarit dhe vepron si mburojë për komunitetin. Nga njëra anë u jep mundësinë autorëve të veprave penale, të cilët kanë mundësi për riintegrim dhe rehabilitim në shoqëri.

Procedurat e riedukimit të të dënuarve në burgje përfshijnë një seri hapash që të lehtësohet evidentimi i secilit rast. Për këtë arsye është shumë i rëndësishëm procesi për kategorizimin e të dënuarit pas marrjes së dënimit. Për të bërë kategorizimin e të dënuarit është i nevojshëm informacioni nga gjykata, veçanërisht dënimet e tij të mëparshme, si dhe kryerja e një interviste me të dënuarin për të marrë informacion të drejtpërdrejtë. Qëllimi është që i dënuari të vuajë në një regjim me siguri të përshtatshme për të dhe programe që plotësojnë nevojat e tij.

Hapi i dytë është zhvillimi i planit të vuajtjes së dënimit. Ky proces përfshin vlerësim për veprën e kryer nëse ka pasur elemente dhune ose nëse krimi ka qenë i natyrës seksuale, sepse këto elemente e rrisin rrezikshmërinë e të dënuarit. Informacion duhet marrë gjithashtu nga vendimi i gjykatës dhe dokumentacioni tjetër i administruar nga gjykata. Informacion duhet

marrë nga raporti para dhënies së dënimit, raportet mjekësore/psikiatrike dhe intervista me të dënuarin. Gjatë kryerjes së intervistës me të dënuarin, punonjësi intervistues duhet të lejojë të dënuarin të shprehë ndjenjat për dënimin e marrë. Në këtë fazë duhet vlerësuar shumë informacioni që vjen nga punonjësit e burgut, nga raportet me shkrim në dosjen e të dënuarit, si dhe nga intervista me të dënuarit. E rëndësishme është që të kuptohet që vlerësimi i rrezikshmërisë dhe i nevojave të të dënuarit nuk është i pandryshueshëm, por duhet riparë dhe ndryshuar në varësi të të dhënave të reja.

Pas vuajtjes së një pjese të dënimit ose me kërkesën e tij, një i dënuar mund të rivlerësohet për sa i përket sigurisë, sepse me kalimin e kohës të dënuarit mund të bëhen më pak të rrezikshëm ose në të kundërt, mund të rritet rrezikshmëria e tyre. Rikategorizimi bazohet në ndryshime të qarta dhe evidente të faktorëve që përcaktojnë rrezikshmërinë e individit. Në këtë fazë vlerësohet rrezikshmëria e të dënuarit ndaj shoqërisë, rreziku i largimit nga vendi i vuajtjes së dënimit, qëndrimi i të dënuarit ndaj autoriteteve dhe bashkëvuajtësve, progresi i bërë në çështjet e përcaktuara si shtysa të kryerjes së veprës penale.

Lirimi me kusht i të dënuarit ose ulja e dënimit

Në këtë fazë është e rëndësishme që të shihen dhe vlerësohen të gjitha informacionet e administruara për të dënuarin në lidhje me rrezikshmërinë e tij, progresin e bërë në objektivat e vendosur, qëndrimin dhe sjelljen e të dënuarit gjatë vuajtjes së dënimit. Periudha gjatë lirimimit me kusht është një pjesë integrale e dënimit dhe për kryerjen e mbikëqyrjes punonjësit e shërbimit të provës duhet t'i referohen planit të vuajtjes së dënimit.

Mbledhja e informacionit është një detyrë e rëndësishme e strukturave drejtuese të burgjeve që mund të kryhet vetëm nëse është zhvilluar një sistem që siguron informacion në kohë dhe të saktë nga struktura brenda dhe jashtë burgut. Kontributet nga brenda burgut zakonisht përfshijnë: personelin e burgut, psikologët, trajnuesit, personelin e sigurisë ose personel tjetër, kërkohet informacion nëse ka pasur kontakte të veçanta me të dënuarin dhe cilat janë konkluzionet e këtyre kontakteve.

Administrata e burgjeve duhet:

- Të studiojë dhe analizojë çdo të dënuar gjatë periudhës së vuajtjes së dënimit;
- Të analizojë veprën e kryer penale dhe rrethanat e motivet;
- Të studiojë mundësitë për parandalim të shkallëzimit në konflikte të reja;
- Të shohë mundësitë e përmirësimit të raporteve të prishura midis viktimës dhe të dënuarit;
- Të dërgojë tentojë negociimin e zgjidhjes së konfliktit mes të dënuarit e viktimës;
- Të dërgojë çështjen për ndërmjetësim kur ka nevojë për shërbim më të specializuar.

Rasti dërgohet në ndërmjetësim kur:

- gjendja shpirtërore e të dënuarit tregon për pendim dhe vrarje ndërgjegje;
- i dënuari paraqet kërkesë për pajtim me persona të tjerë: viktimën e veprës penale apo bashkëpunëtorë të tjerë të dënuar, familjarë të viktimës dhe persona të përfshirë;
- viktima paraqet kërkesë;
- me kërkesën e psikologut ose mjekut që ndjek ose mjekon të dënuarin;
- me kërkesë të qendrës/institucionit ku i dënuari kryen punën ose provën, kur është në gjysmëliri ose kur dënohet me punë publike;
- me kërkesën e familjarëve/të afërmeve të të dënuarit, kur ai vuan dënim me qëndrim në shtëpi.

Hapat e mëtejshëm që ndërmerr administrata e burgjeve janë si më poshtë:

- I jep informacion të dënuarit për alternativën ndërmjetësuese dhe e pyet nëse e pranon të takojë viktimën për të kërkuar falje.
- kur ai jep pëlqimin thërret viktimën ose palën e konfliktuar;
- Analizon tipin dhe personalitetin e palës së konfliktuar;
- Studion me kujdes dosjen e të dënuarit për të evidentuar llojin e konfliktit dhe qëndrimin e të dënuarit ndaj pasojave të veprës;
- Ndërton planin e punës për organizimin e ndërmjetësimit,

përcakton strategjinë që do të ndjekë.

- Kërkon konsulencë nga qendra e ndërmjetësimit për procesin;
- Në rast se procesi ka nevojë për ndërmjetës profesionistë e përcjell rastin në shërbimin e ndërmjetësimit.

Aktmarrëveshja e ndërmjetësimit

Nga natyra e tyre, konfliktet penale në vendet e vuajtjes së dënimit kanë këto rezultate nga zgjidhja e konfliktit me ndërmjetësim: kërkimi i faljes personale ose kryerja e veprimeve që lidhen me faljen publike në media ose në kolektiva ku palët jetojnë e punojnë apo heqja dorë nga ndonjë procedurë e ankimit administrativ apo penal që fillon me kërkesën e të dëmtuarit akuzues, mbështetur në nenet 59 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale.

5. Disa këshilla praktike lidhur me hapat e procesit të ndërmjetësimit viktimë- kundërvajtës

Fillimisht ndërtohet një plan i procesit të ndërmjetësimit. Ndërmjetësi takon të dyja palët veç e veç. Këto takime individuale luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e ndërmjetësimit. Ndërmjetësi, duke dëgjuar historitë e secilës palë, strukturon programin dhe inkurajon pjesëmarrjen e tyre.

Në përgjithësi, ndërmjetësi takon në fillim të akuzuarit dhe më pas takojnë viktimat. Kjo seancë paraprake konsiston në mbledhjen e informacioneve rreth ngjarjes kriminale dhe në shpjegimin e programit për palët. Këto takime individuale sigurojnë mundësi për ndërmjetësin të ndërtojë një raport dhe të arrijë të krijojë një atmosferë besueshmërie të ndërsjellë. Këto takime paraprake ndajnë viktimat dhe të akuzuarit, duke kërkuar dëgjime efektive dhe një komunikim të shpejtë. Pjesëmarrja e të akuzuarit në procesin e ndërmjetësimit është krejtësisht vullnetare.

Nëse viktimat dhe i akuzuari kanë qëndrim të palëkundur për të marrë pjesë në ndërmjetësim, ndërmjetësi më pas planifikon një takim kokë më kokë me të dyja palët. Sesioni i ndërmjetësimit fillon me shpjegimin nga ana e këtij të fundit, për rolin e tij ose të saj, duke deklaruar çdo komunikim, duke përmendur rregullat që mund të jenë të nevojshme, duke

bërë të ditur gjithashtu edhe axhendën e takimeve, (si fillim për të folur për çka ndodhi dhe si ndihen dhe më pas të diskutojnë humbjet, si dhe marrëveshjet e zgjidhshme).

Përgjatë takimit të parë të ndërmjetësimit, vëmendja përqendrohet më tepër në fakte dhe në ndjenjat lidhur me krimin. Viktimat e krimit kanë dhënë një mundësi jo të zakonshme për të shprehur ndjenjat e tyre ndaj personit që ushtroi dhunë mbi ta. Ata mund të marrin përgjigjen e pyetjes si p.sh “përse unë?”, “si më morët në shtëpinë tuaj?” dhe “kur na gjurmuat dhe kur menduat të na ktheni mbrapsht?” Në vështrimet e dhunuesve/shkelësve të tyre, viktimat kanë mundur të mbijetojnë.

Të shohin pamjen e viktimës, për shumë të akuzuar nuk është e lehtë. Kjo është një gjendje jo komode për dhunuesit/shkelësit, ata japin të njëjtën mundësi jo të zakonshme për të shfaqur pamje më njerëzore në karakterin e tyre. Por nga ana tjetër, edhe për viktimën është e vështirë të ulet me dhunuesin e tij dhe të flasë “sy ndër sy”.

Pasi të dyja palët kanë arritur në përfundim duke diskutuar mbi krimin dhe si ndiheshin ata, ndërmjetësi duhet ta orientojë bisedimin drejt së ardhmes. Viktimat shohin në perspektivë, duke pasur një plan për t'i bërë gjërat mirë. Në të shumtën e rasteve, viktimat shprehen optimiste përgjatë marrëveshjeve finale të pajtimit.

Kur gjykata u referohet rasteve të ndërmjetësimit, ata, në të shumtën e rasteve, nuk arrijnë në një rikthim të plotë. Në rastet në të cilat njëra palë nuk është dakord me formën e ndërmjetësimit realizohet një tjetër program ripërtëritjeje për dhunuesin/shkelësin. Ndërmjetësi, në raste të tilla, nuk propozon zgjidhje ripërtëritëse.

Shumë programe tregojnë se në 95% të rasteve të sesioneve ndërmjetësuese, marrëveshjet kanë dalë me sukses dhe të qarta për viktimat, shkelësit, si dhe ndërmjetësit. Seancat e ndërmjetësimit viktimë-kundërvajtës zakonisht zgjasin një deri në 2 orë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE

UDHËZUES ¹

PËR REFERIMIN DHE OFRIMIN E SHËRBIMIT TË NDËRMJETËSIMIT VIKTIMË-KUNDËRVAJTËS, DREJTËSI RESTAURUESE PËR TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN

Drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi viktimë-kundërvajtës janë forma bashkëkohore të trajtimit dhe zgjidhjes së konflikteve penale jashtë rrugës gjyqësore. Përmes këtij mekanizmi synohet të riparohen dëmet që shkaktohen nga veprat penale të miturit si viktimë dhe si shkakhtarë të dëmit. Arritja e zgjidhjes është rezultat i bashkëpunimit dhe komunikimit aktiv të palëve në proces (të viktimës, të akuzuarit dhe pjesëtarëve të komunitetit në prani të një pale të tretë, të paanshme dhe të pavarur që është ndërmjetësi, si dhe përmes formave të tjera të drejtësisë restauruese si të takimit në grup dhe rrethit të paqes.

Stafet e shërbimit në sistemin e paraburgimit dhe të vuajtjes së dënimit për të mitur dhe të rinj deri në 21 vjeç janë në komunikim dhe marrin dijeni lidhur me konflikte të mundshme, ku janë përfshirë të miturit dhe të rinjtë dhe që në vlerësimin e tyre mund të referohen për t'u trajtuar dhe zgjidhur përmes ndërmjetësimit viktimë - i akuzuar drejtësi restauruese. Gjithashtu, stafet e shërbimit në sistemin e paraburgimit dhe të vuajtjes së dënimit marrin kontakt edhe me të dëmtuarit, (viktimën), si dhe komunitetin e prindërve.

Me firmosjen e këtij Udhëzuesi mundësohet institucionalizimi i procesit bashkëpunues ndërmjet Institucionit të Shërbimit të Burgjeve dhe

1. Miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, Nr.4676, Prot. Datë 20.05.2015, "Mbi miratimin e udhëzuesit për referimin dhe ofrimin e shërbimit të ndërmjetësimit viktimë-kundërvajtës, drejtësi restauruese për të miturit në konflikt me ligjin".

Shërbimit të Ndërmjetësimit për ofrimin e zgjidhjes alternative përmes drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit për të miturit në konflikt/kontakt me ligjin.

Rëndësia e Udhëzuesit për Administratën e Burgjeve

Udhëzuesi është një dokument që synon të vendosë një gjuhë komunikimi që duhet të përdorin institucionet me qëllim që të adresojnë në mënyrë profesionale çështje që lidhen me referimin (devijimin) apo shmangien nga sistemi tipik i drejtësisë penale të një individi i cili ndonëse ka kryer një shkelje të ligjit penal, vlen të trajtohet nga sistemi drejt alternativave të zgjidhjes dhe rehabilitimit, të cilat kanë një sërë përfitimesh kundrejt operacioneve tradicionale të ndëshkimit.

Udhëzuesi synon rritjen e cilësisë së shërbimit në institucionet e vuajtjes së dënimit, rritjen e shkallës së edukimit të personave që vuajnë dënimet në burgje, forcimit të partneriteteve me prokurorinë, policinë, avokatinë si mënyra më e përshtatshme e veprimit në një shtet demokratik, rritjen e kapaciteteve parandaluese dhe rritjen e shkallës së integritetit të personave të dënuar në shoqëri.

Baza ligjore ku mbështetet Udhëzuesi

- Ligji nr. 10032/12.11.2008 “Për Policinë e Burgjeve”
- Kodi i Procedurës Penale, në referim të neneve 59 dhe 284, përfshihen vepra penale të parashikuara nga nenet 89, 90, 91, 92, 102/1, 105, 106, 112/1, 119, 120, 121, 122, 125, 127, 130, 148, 149, 239, 240, 241, 243, 254, 264, 275 dhe 318 të Kodit Penal.
- Ligji nr. 10835/24.2.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, neni 2, pika 1.

Roli i punonjësit të edukimit dhe të shërbimit të sigurisë në raport me shërbimin e ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese

Punonjësi i edukimit dhe i sigurisë në sistemin e paraburgimit dhe vuajtjes së dënimit për të miturit në konflikt me ligjin, pasi konstaton konfliktin e mundshëm ku është i përfshirë i mituri dhe pasi e çmon se rasti është i përshtatshëm për t’u referuar në ndërmjetësim dhe praktikë

restauruese:

- Informon të miturin dhe familjen e tij mbi mundësinë që ka për t'i ofruar mbështetje për të ndërmjetësuar me të dëmtuarin, si dhe e fton atë për t'u bërë pjesë e këtij procesi;
- Bën referimin e rastit në shërbimin e ndërmjetësimit brenda 72 orëve nga identifikimi i konfliktit;
- Harton një letër referencë dhe në emër të institucionit ia dërgon shërbimit të ndërmjetësimit me të cilin ka marrëveshje bashkëpunimi ku i kërkohet ofrimi i shërbimit të ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese për palët e përfshira në konflikt;
- Komunikon me ndërmjetësin ose ndërmjetësit e prezantuar në listë nga Shërbimi i Ndërmjetësimit për të rënë dakord mbi datën, orën e takimit ku i mituri dhe pala e dëmtuar do të paraqitet pranë shërbimit të ndërmjetësimit;
- Përfshihet aktivisht në zbatimin dhe monitorimin e veprimtarive të Shërbimit të Ndërmjetësimit që realizohen me qëllim sigurimin që Shërbimi i Ndërmjetësimit i përmbush detyrimet e saj dhe shërbimi që i ofrohet të akuzuarit është cilësor dhe eficient;
- Përfshin në dokumentacionin e përgatitur bashkëpunimin me Shërbimin e Ndërmjetësimit dhe rezultatet e tij;
- Kur si rrjedhojë e ndërmjetësimit, midis palëve është arritur një marrëveshje për zgjidhjen me pajtim të çështjes dhe kur kjo nuk bie në kundërshtim me ligjin, punonjësi i edukimit dhe i sigurisë në sistemin e paraburgimit dhe vuajtjes së dënimit njofton me shkrim arritjen e marrëveshjes dhe e konsideron çështjen të mbyllur;
- Në rastet kur palët e përfshira në konflikt nuk bien dakord dhe për rrjedhojë nuk arrihet një marrëveshje e nënshkruar ndërmjet tyre vazhdon procesi i trajtimit të rastit sipas procedurës penale.

Roli i Shërbimit të Ndërmjetësimit dhe Drejtësisë Restauruese

Në marrëdhënien e bashkëpunimit me institucionin e shërbimit të paraburgimit dhe të vuajtjes së dënimit për të mitur, shërbimi i ndërmjetësimit:

- Nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit me institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve;
- Depoziton pranë institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve listën e ndërmjetësve të licencuar nga Komisioni i Licencimit të Ndërmjetësve pranë Ministrisë së Drejtësisë me gjeneralitetet dhe kontaktet e tyre.
- Siguron që ndërmjetësi/ndërmjetësit që ofrojnë shërbimin e tyre janë të trajnuar në çështje të ndërmjetësimit dhe të drejtësisë restauruese;
- Kryen veprimet e nevojshme për të kontaktuar veçmas të dëmtuarin dhe shkaktarin e dëmit me qëllim përgatitjen e tyre paraprake për seancat e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit;
- Informon institucionin e shërbimit të paraburgimit dhe vuajtjes së dënimit për të miturit mbi përputhshmërinë e çdo rasti me programet e ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese;
- Mundëson organizimin e një takimi të qetë, të sigurt dhe në përputhje me ligjin për ndërmjetësimin.
- Përfshin në procesin e ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese prindërit e të miturve në konflikt dhe kur është e përshtatshme dhe e mundshme edhe anëtarë të komunitetit, psikologë ose dhe punonjës të institucionit, me qëllim arritjen e rezultateve në përmirësimin e marrëdhënies midis palëve, riparimin e dëmit të shkaktuar dhe parandalimin e përshkallëzimit të konfliktit.
- Informon institucionin e shërbimit të paraburgimit dhe vuajtjes së dënimit për të miturit mbi ecurinë e procesit të ndërmjetësimit në mënyrë periodike;
- Në rastin kur të dyja palët në konflikt janë të mitur në institucion, procesi i ndërmjetësimit duhet të përfundojë brenda 7 ditësh dhe nëse në konfliktin e referuar janë të përfshira dhe palë jashtë institucionit dhe rasti konsiderohet i vështirë, procesi i ndërmjetësimit duhet të përfundojë brenda afatit 20-30 ditë.
- Informon institucionin kur çmon se për arsye objektive ose subjektive procesi i ndërmjetësimit nuk mund të kryhet, duke përshkruar dhe shkaku;
- I përgjigjet me shkrim çdo kërkesë të policisë për informacion mbi një rast të caktuar bashkëpunimi.
- Në përfundim të procesit të ndërmjetësimit, Shërbimi i

Ndërmjetësimi i paraqet institucionit:

- Një letër informuese rreth zhvillimit të procesit ndërmjetësues dhe drejtësisë restauruese - aktmarrëveshjen e firmosur nga palët kur ajo bëhet e mundur;
- U paraqet kopje të marrëveshjes së arritur palëve të përfshira në konflikt;
- Kur nuk arrihet nënshkrimi i marrëveshjes së ndërmjetësimi i paraqitet institucionit referues një raport përmbledhës ku shprehet procesi ndërmjetësues i realizuar dhe arsyet e pamundësimi të arritjes dhe firmosjes së marrëveshjes së ndërmjetësimi ndërmjet palëve të përfshira;
- Kur është arritur një marrëveshje midis autorit të dëmit dhe të dëmtuarit, ndjek në vijimësi përmbushjen e marrëveshjes dhe i raporton policisë mbi përmbushjen ose jo të detyrimeve të marra përsipër nga palët;
- Shërbimi i Ndërmjetësimi, në veprimtarinë e tij, respekton kërkesat e Ligjit Nr. 9877, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Shtojca

1. Model i njoftimit që përdor institucioni referues për referimin e çështjes për ndërmjetësim



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE
INSTITUCIONI I EKZEKUTIMEVE TË VENDIMEVE PENALE - _____
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. _____ Prot. _____, më ____/____/____

NJOFTIM

Drejtuar: Shërbimit të Ndërmjetësimit _____

Lënda: Referimi i çështjes në shërbimin e ndërmjetësimi

Duke pasur parasysh natyrën e mosmarrëveshjes dhe vullnetin e palëve për gjetjen e një zgjidhjeje miqësore, përmes këtij njoftimi bëjmë të ditur se zyra jonë e referon çështjen _____ (lloji i mosmarrëveshjes) ndërmjet:

Pala e parë _____ (informacion mbi palët)

dhe

Pala e dytë _____

Shpresojmë në gjetjen e një zgjidhjeje të konfliktit midis palëve.

Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimit Social

2. Model i Marrëveshjes së Ndërmjetësimit

**Logo e institucionit që ofron
shërbimin e ndërmjetësimit**

MARRËVESHJE

Sot, më datë: ___/___/___, në: _____, në përputhje me Ligjin Nr. 10 385, datë 24.02.2011, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, dhe nenit 338 dhe 171 të Kodit të Procedurës Penale, nënshkruhet kjo marrëveshje ndërmjet:

(informacion mbi palët)

1. _____

2. _____

Përshkrimi i mosmarrëveshjes: _____

Detyrimet dhe kushtet e vendosura nga palët:

Mënyrat dhe afatet për përmbushjen e tyre:

Me vullnetin e tyre të lirë, palët deklarojnë se do t'i përmbushin me korrektësi të gjitha detyrimet dhe kushtet reciproke të përcaktuara në marrëveshje.

Pala e parë

Pala e dytë

Ndërmjetësi

3. Model i Njoftimit që dërgon Shërbimi i Ndërmjetësimit në institucionin referues

Logo e institucionit që ofron
shërbimin e ndërmjetësimit

Nr. _____ Prot.

Datë, ____ / ____ / _____

NJOFTIM

Drejtuar: _____

Lënda: Mbi përfundimin e procedurës së ndërmjetësimit

Në përgjigje të shkresë suaj nr. _____ prot., datë ____/____/_____, dhe në respektim të Ligjit nr. 10385, datë 24.02.2011, “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, ju njoftojmë përmes këtij dokumenti për përfundimin me sukses/pa sukses të procedurës së ndërmjetësimit, ndërmjet palëve të mëposhtme:

1. _____
2. _____

Me Ndërmjetës: Z./Znj. _____

Ju lutemi, gjeni bashkëlidhur aktet përkatëse të çështjes.

(emri, mbiemri)

(përfaqësuesi i shërbimit të ndërmjetësimit ose ndërmjetësi)

Save the Children

Rruga Komuna Parisit, Pallatet 1 Maji, Vila Lami

PO Box 8185, Tiranë

Tel.: +355 (0)4 2261840/929, 2266227

Fax: +355 (0)4 2263428

E-mail: info.albania@savethechildren.org

[Http://albania.savethechildren.net](http://albania.savethechildren.net)

**Fondacioni "Zgjidhja e Konflikteve
dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve"**

Rruga "Him Kolli", Pall. P.F.Trade, Nr. 5, Tiranë

Tel.: +355 (0)4 2248681; Tel/Fax: +355 (0)4 2264837

E-mail: mediationalb@abcom.al

[Http://www.mediationalb.org](http://www.mediationalb.org)